




## Republika e Kosovës Komuna e Vushtrrisë

### MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

**Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA - INFRAKOS** me lokacion në Sheshi i Lirisë pn. 12000 Fushë Kosovë, e përfaqësuar nga **z. Xhevat Ramosaj UD**, Kryeshef Ekzekutiv, në tekstin në vijim: (INFRAKOS)

dhe

**Komuna e Vushtrrisë** e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës **z. Xhafer Tahiri** në tekstin në vijim: (Komuna)

Palët në vijim bashkërisht do të ceken si “Palët sipas marrëveshjes” dhe pajtohen që të lidhin marrëveshjen si me poshtë;

### QËLLIMI DHE LËNDA E MARRËVESHJES

#### Neni 1

Marrëveshja e lidhur ndërmjet INFRAKOS dhe Komunës ka për qëllim bashkëpunimin në mes palëve në fushat si më poshtë:

- Riorganizimin e aspekteve të sigurisë hekurudhore brenda qytetit të Vushtrrisë dhe rregullimin ligjor të pronës së INFRAKOS-it;
- Komuna nuk do ta pengojnë projektin e rehabilitimit të linjave dhe objekteve tjera hekurudhore dhe se do ta ndihmojë në çdo aspekt INFRAKOS-in;
- INFRAKOS-i do të ketë mirëkuptim për projektet e rëndësisë publike të komunës, por gjithnjë duke i orientuar ato që kërkesat eventuale për shfrytëzim të pronës së INFRAKOS-it të kalojnë dhe miratohen nga qeveria;
- Koordinimin e të gjitha çështjeve lidhur me Infrastruktura Hekurudhore, infrastrukturën e Komunës që ndërlidhet me pronën apo infrastrukturën hekurudhore me qëllim të ofrimit të zgjidhjeve në interes publik, në interes të dy entiteteve dhe aspekteve tjera të bashkëpunimit në funksion të interesit publik.

## **OBLIGIMET E PALËVE**

### **Neni 2**

#### **Obligimet e Komunës së Vushtrrisë**

- 2.1 Komuna nuk do t'i pengojë projektet e rehabilitimit të linjave dhe objekteve hekurudhore dhe se do ta ndihmojnë në çdo aspekt INFRAKOS-in;
- 2.2 Prona, infrastruktura hekurudhore dhe objektet përcjellëse të Infrastrukturës së Hekurudhave të Kosovës - INFRAKOS ShA, si pronë shtetërore në asnjë rast nuk do të jetë objekt i trajtimit të organeve komunale pa njoftimin dhe pëlqimin paraprak të NP INFRAKOS ShA.
- 2.3 Planet rregulluese dhe zhvillimore urbane dhe ato të përgjithshme të qytetit dhe komunës në të ardhmen, duhet të përshtaten në atë mënyrë që të mos dëmtohet prona, infrastruktura hekurudhore dhe objektet përcjellëse të saj me qëllim të zhvillimit të sigurt të komunikacionit hekurudhor dhe veprimtarisë tjetër komerciale të saj.
- 2.4 Komuna do të lejoj dhe ndihmoj INFRAKOS-in në riorganizimin e Stacionit Hekurudhor në Vushtri sipas kërkesave dhe nevojave të projekteve zhvillimore të INFRAKOS-it, duke përfshi edhe mundësinë e ndërtimit të Stacionit multimodal;
- 2.5 Obligohet Komuna që në të gjitha rastet ku paraqitet nevoja të shfrytëzohet prona e INFRAKOS-it në interes publik, paraprakisht duhet të zhvilloj procedurat ligjore për shpronësim të hapësirave / pronës për të cilën INFRAKOS jep pëlqimin paraprak;
- 2.6 Komuna merr përsipër që të koordinoi punët dhe veprimet me INFRAKOS-in gjatë zhvillimit të projekteve komunale të cilat prekin pronën e INFRAKOS-it.
- 2.7 Komuna do të mbuloj të gjitha kostot financiare dhe shpenzimet tjera eventuale që mund t'i shkaktohen INFRAKOS-it gjatë implementimit të projekteve të komunës e të cilat prekin pronën e INFRAKOS-it;
- 2.8 Komuna obligohet të kërkoj pëlqim paraprak nga INFRAKOS-i për të gjitha rastet ku preket apo cenohet prona e INFRAKOS-it;
- 2.9 Komuna do të lejojë riorganizimin e pronës së INFRAKOS-it në Vushtri për qëllime komerciale;
- 2.10 Komuna do të bashkëpunoj dhe ndihmoj INFRAKOS-in përmes dhënies së pëlqimeve dhe lejeve për qëllime komerciale në pronën e INFRAKOS-it në Vushtri sipas propozimit të INFRAKOS-it;
- 2.11 Komuna merr për obligim lirim dhe pastrimin e hapësirave të INFRAKOS-it brenda qytetit të Vushtrri nga uzurpatorët, ndërtimet pa pëlqim të INFRAKOS-it dhe pa leje të Komunës, si dhe të bëjë lirim dhe hapësirave që shfrytëzohen pa kontrata me INFRAKOS-in;
- 2.12 Komuna obligohet që gjatë hartimit të hartave zonale për pjesët ku gjendet prona e INFRAKOS-it në Vushtri do të konsultohet në vazhdimësi me INFRAKOS-in;
- 2.13 Komuna merr përsipër përkufizimin e pronës së INFRAKOS-it, rregullimin e dokumentacionit kadastral dhe historikut të dokumentacionit kadastral dhe sipas

kërkesës së INFRAKOS-it do të bëjë bartjen e pronave të INFRAKOS-it sipas emërimit të ri ligjor të ndërmarrjes.

### **Obligimet e INFRAKOS-it**

- 3.1 NP INFRAKOS ShA. është ndërmarrje e veçantë publike dhe person i veçantë juridik dhe pronën e vet e menaxhon në bazë të Ligjit Nr. 04/L- 063 për Hekurudhat e Kosovës.
- 3.2 Sipas kërkesës së Komunës së Vushtrrisë INFRAKOS-i mund të jap pëlqime për shfrytëzim të pronës së vet në interes publik në rast se nuk cenohet siguria e komunikacionit hekurudhor, nuk cenohet zhvillimi i projekteve hekurudhore, nuk cenohet funksionaliteti i linjave Hekurudhore dhe nuk cenohet interesi financiar i Kompanisë;
- 3.3 Në rast se INFRAKOS-i jep pëlqime sipas pikës së mësipërme të këtij neni, Komuna duhet të zhvilloj paraprakisht procedurat ligjore për shpronësim në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- 3.4 INFRAKOS-i sipas nevojës do të formoj komisionet përkatëse – profesionale për realizimin e obligimeve të ndërsjella që rrjedhin nga kjo Marrëveshje;
- 3.5 INFRAKOS-i ruan të drejtën që në rast të mos përmbushjes së detyrimeve nga ana e Komunës të ndërpres këtë marrëveshje, të kërkoj nga Komuna të rikthej gjendjen e mëparshme, të kërkoj kompensim për dëmet e shkaktuara dhe të filloj procedura eventuale ligjore ndaj Komunës dhe zyrtarëve përgjegjës;

### **Neni 4**

#### **Shpronësimi eventuale**

- 4.1 Komuna e Vushtrrisë obligohet që në të gjitha rastet kur është e nevojshme paraprakisht të zhvilloj procedurat për shpronësim të hapësirave/pronës për të cilën INFRAKOS-i jep pëlqimin paraprak;
- 4.2 Procedura e shpronësimit duhet të zhvillohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kompetent për shpronësimin e pronës së INFRAKOS-it është Qeveria e Kosovës.
- 4.3 Pas zhvillimit të procedurave të shpronësimit, Komuna e Vushtrrisë obligohet që të bëjë pagesën e vlerës së përcaktuar nga organi kompetent brenda afateve ligjore pa vonesa në llogarinë bankare të INFRAKOS-it;
- 4.4 Në rast të mos inicimit të procedurave ligjore me kohë apo për mos angazhimin e duhur nga Komuna e gjithë përgjegjësia bie mbi Komunën dhe INFRAKOS-i do të kërkoj përmes procedurave ligjore rikthimin e pronës.

## Neni 5

### Zgjidhja mosmarrëveshjeve

- 5.1 Në rast të paraqitjes së ankesave apo mosmarrëveshjeve në lidhje me këtë Marrëveshje, palët duhet të shfrytëzojnë përpjekjet më të mira që mospajtimet të zgjidhen miqësisht mes Palëve;
- 5.2 Palët pajtohen mes veti që kjo Marrëveshje do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e aplikueshme në Kosovë dhe kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është Gjykata Themelore në Vushtri
- 5.3 Nëse cilado prej dispozitave të Marrëveshjes konsiderohet nga Gjykata kompetente të jetë e kundërligjshme, e pavlefshme apo e pazbatueshme, dispozitat e mbetura do të mbesin në fuqi dhe do të prodhojnë efekte juridike.

## Neni 6

### Dispozitat përfundimtare

- 6.1 Marrëveshja është e shkruar në gjuhën shqipe dhe e nënshkruar në 4 (katër) kopje, prej të cilave, secila palë mban nga dy kopje;
- 6.2 Marrëveshja e nënshkruar nënkupton se palët janë pajtuar ndërmjet veti dhe obligimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje do t'i përmbushin;
- 6.3 Marrëveshja hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj nga të dyja palët.

Datë: 00 / 00 / 2020

**Z. Xhevat Ramosaj**

UD i Kryeshefit Ekzekutiv të INFRAKOS



**Z. Xhafer Tahiri**

Kryetar i Komunës së Vushtrisë

